**ADEM ZAPLLUZHA**

# DRITARET E VERBËTA

Redaktor:
Dedë Preqi

Recensent:
Mazllum Baraliu

lektor:
Veli Veliu

**ADEM ZAPLLUZHA**

# DRITARET E VERBËTA

"TREND"
2015

# *Një erë e fortë po frynë nga kujtesa*
# *Cikli i parë*

# VËSHTRIME QË ZGJOJNË KURESHTJE, NGA LIBRI „DRITARET E VERBËTA“ TË AUTORIT ADEM ZAPLLUZHA

Dedë Preqi

Secili njeri ëndërron thesarin e vet, duke dashur ta ketë, i bindur se atij personi do ti printe fati dhe një ditë do ti numëroj monedhat e fituara. Por thesari është i lidhur me diçka tjetër dhe plotësimi i dëshirave është i tëri i pa mundur, sepse jeta ka shumë ura dhe rrugë që duhet të kalohen, do të jetë e pa mundur ti plotësojë të gjitha. Kështu i nisa këta rreshta për thesarin e autorit Zaplluzha, i cili jo vetëm që ka ëndërruar për një thesar të tillë, por ai vetë e ka realizuar në jetën e vet, duke krijuar një thesar të çmueshëm dhe shumë të rëndësishëm, i cili nuk krahasohet me monedha, por as me florinj.

Kështu, thesari i thjeshtë, por shumë i çmuar i autorit Zaplluzha fillon shumë herët, që në ditët e fëmijërisë së tij, dhe ky thesar ditë përditë fillon të rrjedh sikur lumi, duke i vënë vulën e vet çdo gjëje, dhe njerëzve dhe frymëmarrjes së tyre, bimëve të njoma e të lëngshme, barit dhe tokës së butë pjellore, si dhe ndryshimeve të kohës, kur ajo shpeshherë e ndërronte motin. Sa më shumë që koha kalon dhe pesha e moteve rëndon mbi supat e autorit, aq më shumë thesari i autorit shtohet dhe merr përmbajtje, ngjyrë dhe kuptim , duke u

gdhendur së bashku me shpresat e njerëzve, nevojat, apo plogështit e tyre, si dhe me ngjarjet reale që shqetësojnë njerëzit e pafajshëm, të cilët ishin të etur për jetën dhe lirinë e tyre njerëzore.

Thesari i autorit dhe poetit të madh Adem Zaplluzha, nuk është thesar që shndërrohet në të holla, apo mall shkëmbimi, thesari i tij është vetë p o z i a, thesar më i pa krahasueshëm që kurdoherë e ka vlerën e vet të pa tjetërsueshme, që trashëgohet në breza, dhe shkrihet nën peshën e vjetëve, me veçantitë dhe qëndrueshmërinë e saj, duke kaluar nëpër gjitha ndërrimet e moteve, që lëshojnë rrënjë sa më thellë në vetëdije dhe poetikën shqipe. Letërsia shqiptare përbëhet nga një lum i madh, por kur lëshohen edhe rrjedhat tjera, krijohet një oqean vlerash, të cilat janë burime të pashtershme dhe rrjedha të veçanta të frymëzimeve dhe logjikave njerëzore.

Libri me poezi „Dritaret e verbëta“, i autorit Zaplluzha, është i 122-ti, me radhë, dhe ecja e poetit do të thotë nuk përfundon aq lehtë, duke krijuar për çdo ditë nga një „kullë letrare“ , si duket temperamenti krijues i autorit realizohet me sukses në shtigjet e një gjerësie dhe hapësire të tillë, si argument i fuqishëm dhe i frymëzuar i autorit, mbi të cilin mbështetët ky opus i rëndësishëm i veprave letrare. Ky libër ndahet në tri cikle, të cilat disponojnë një mozaik të brendshëm të logjikës së fuqishme i mendimeve të poetit Zaplluzha, që kanë jo vetëm pikëpamje poetike, por disa poezi kanë

edhe pikëpamje filozofike. Autori Zaplluzha, me natyrën e vet krijuese është një vëzhgues i përpiktë i kohës, jo asaj meteorologjike, por edhe i përcjelljes politike, i cili disponon durim të mjaftueshëm për ti thënë gjërat në çastin e duhur, si një karakteristikë e veçantë e poetit, që ka pretendime të rrufeshme krijuese me përshtypje të mira dhe me shkathtësi të pa para, për ta ruajtur dhe për t'ia mbajtur të gjallë krijimtarinë e tij poetike dhe patriotike.

Cikli i parë fillon me „Makthet e netëve pa gjumë", cikli i dytë me „Dritaret e verbëta" dhe cikli i tretë me „Tinëzisht rrotullohen zërat e fatit".

Cikli i parë**, M a k th e t e n e t ë v e p a gj u m ë**

**„Nga duart e lypsarëve zgjohen trishtimet**
**Zgjohen me ëndrrat e sëmura**
**Makthet e netëve të pa gjumë".**

Autori Zaplluzha, edhe në veprat tjera me poezi, në mesin e tyre ka episode të ndryshme të shkëputura që rrëfejnë shpesh herë gjendjen e mjerueshme dhe fatin e popullit të vet, pikërisht edhe këtë herë poeti shpreh dhembjen dhe mjerimin e lypsarëve, të cilët mbetën nën mëshirën e kohës, apo të shoqërisë njerëzore. Mandej, poezia Nga frika ose mosdija,

„**Vdisnit vetëm për të ju lavdëruar i huaji**
**Një pjesë të një gjymtyre**
**E varrosët në rërat e huaja**
**Kurse në atdhe s'patët vend për një kryq**".

Janë këto vargje të ndieshme, të cilat mund të mirren si paralajmëruese dhe sinjal për kahen e linjes tonë shoqërore, që jeta i hedh dhe i përcjellë në margjina të ndryshme, dhe sikur nuk është në gjendje që ti mbajë të gjithë penjtë e diskrecionit në duart e veta. Poeti në këtë rast ngre një porosi, sidomos për ata që jetojnë jashtë atdheut, një detaj ku autori ndjekë lirikën e vet sipas rrëfimeve realiste dhe ngjarjeve të vërteta të atyre që përjetojnë jetën diku larg, jashtë rrethit dhe atdheut të vet, duke lënë edhe një pjesë të gjymtyrëve në ato vende.
Marrim dhe vargje të tjera nga poezia, Ngjanë ecjes së këtyre maleve.

**„Njerëzit dhe drurët e atdheut tim**
**Janë të ngjizur për këto male**
**Në shpirtin e secilit zgjohet**
**Një dashuri e pa parë**
**Kur i dëgjojnë daullet e kushtrimit“**

Prandaj, edhe në këto vargje lirike të poetit Zaplluzha, ndjehet jehona e tingujve të lirisë, e cila buron nga njerëzit e vendit, që poeti i zëvendëson me drurët e maleve dhe ushqehet nga shpirti i secilit dhe zgjohet në kushtrim për liri me dashuri.

-**Cikli i dytë , D r i t a r e t e V e r b ë t a**

**„Nga një libër i vjetër**
**Trishtueshëm i shkundi**
**Trishtimet e një jete**

**Shkundi edhe vetveten**
**Nga një përgjumje e përdalë,**
**Një zog me krih të thyer**
**Noton mbi sterrën e plumbtë**
**Dritaret e verbëta**
**As nuk hapën, as nuk mbyllën**
**Qetësia po i çmend mushkonjat e verdha“**

Në fakt autori nuk fshehë sekretet e veta poetike, por ato i shpalos para lexuesit, edhe pse ndoshta e quan vetën si një zog me krih të thyer, dhe dritaret e verbëta, as nuk hapën e as nuk mbyllën, prapë se prapë gjen rrugë të tjera, të cilat janë shtigjet e jetës së hidhur dhe të ëmbël, që duhet sprovuar.
I nxjerrim edhe disa vargje nga poezia, N u k di a t’i shkruaj një lutje Z o t i t.
**„Nuk di a t’i shkruaj një lutje zotit**
**Apo ti urdhëroj**
**Edhe nëse këtë e bëjë**
**Kot do ta kam**
**Zoti im nuk di shqip**
**As unë se njoh gjuhën e tij“**

Kjo është një metaforë e poetit, i cili ka të drejt të bëjë edhe një pyetje të tillë, duke iu drejtuar Hyut të vet, edhe pse nuk e njohin gjuhën e njëri-tjetrit, por më rëndësi është se lutja është një tingull, apo heshtje, që realizohet në gjuhë të ndryshme, por përkthehet në një gjuhë të vetme para Zotit.

Poeti i këndon edhe moshës, sikur në poezinë, **A h k u r i sh a i r i.**

**„Kur isha i ri**
**Ah kur isha i ri,**
**Vetëm një poet rebel**
**Mund të krahasohet me mua**
**Unë kurrë nuk e besoja**
**Se do të plakem një ditë kaq shumë“.**

Sa e rëndësishme është jeta dhe periudhat e saja, por ajo në çdo kohë i ka përshtypjet e veta, të cilat lejnë vragë të pa shlyera edhe në rini, por edhe në pleqëri. Edhe pse poeti mendon se njeriu plaket shumë shpejt, por kohën nuk mundet askush ta ndal, dhe si e tillë atë, duhet shfrytëzuar për të mirë, pa i humbur meritat e saj.

-Cikli i tretë, **T i n ë z i sh t rr o t u ll o h e n z a r e t e f a t i t**

„**Nëpër kafenetë e mbyllura**
**Tinëzisht rrotullohen zaret e fatit**
**Ky rulet xhepi**
**Për çdo natë në lokalet e pista**
**Kafshon nga një shpirt të lënduar“**

Vetë fjala, zaret e fatit e ka kuptimin e lojërave fatale që njerëzit marshojnë edhe pse më shumë humbin se fitojnë. Prandaj, shprehja figurative e poetit është analizë e qartë e rrëfimeve të fateve njerëzore që lozin me jetën dhe fatin e vet, duke e lënë edhe pjesën e fundit të pasurisë së vet në

rrotullzën e fatit, e cila është një lojë e pistë dhe e rrezikshme, sidomos për ata që mendojnë përmes kësaj loje të përfitojnë, duke mbet shpesh herë me gishta në gojë.

Po ashtu, edhe në poezinë, **Çdo kush do më njihte se jam shqiptar**

**„Po të isha edhe në fund të botës**
**Smund të jem asgjë tjetër**
**Përpos një imazhi të bardhë**
**Që i përngjanë**
**Maleve të Sharrit me qeleshe.**
**Po të isha edhe në fund të botës**
**Në mesin e njerëzve më krenarë**
**Me këtë bardhësi shpirtërore**
**Çdo kush do më njihte se jam shqiptar“.**

Përndryshe, kjo vepër e poetit Zaplluzha, është një lirikë e shfrenuar për një hapësirë të pafund, të prirjes së poetit dhe për efektet letrare, me ç’rast lexuesi ka mundësi të zgjedh nga më të mirat në disponimin e vet. Në këtë mënyrë, penda e poetit Zaplluzha i ka karakteristikat e veçanta, e cila gjithherë shërbehet me ngjyrën e pa anshme të shprehjes artistike letrare, dhe cila asnjëherë nuk shndërrohet vetëm për qëllime vetiake, për të kënaqur motive interoverte, por gjithherë në shërbim të kuptimit më të mirë letrar dhe atij njerëzor. Të gjithë ata poet dhe krijues që disponojmë qëllime të tilla, s’ka dyshim se edhe letërsia shqiptare do të mbështetet dhe

përqendrohet në këto shtylla të forta, e cila nuk e ka vështirë të shënojë edhe historinë e vet të qëndrueshme dhe të lavdishme.

## MAKTHET E NETËVE PA GJUMË

Si devetë e bardha të shkretëtirës
Ecin lisat
Ecin duke i përtypur gjethet

Nga majat e degëve të thyera
Si kërthinjtë e lënë nëpër faltore
Dëgjohen cijatjet e zogjve të braktisur

Një natë me shi të brymtë
Si kjo e këtyre çasteve
Ka kohë që nuk ka qenë në qytetin tonë

Nga duart e lypsarëve zgjohen trishtimet
Zgjohen me ëndrrat e sëmura
Makthet e netëve pa gjumë

Diku në fund të lagjes
Plepat e fëmijërisë i zgjasin duart
Kah dritaret e mbyllura

Era e lodhur nuk frynë më
Kanë heshtur armët
Nëpër paradhomat e mendjeve të shthurura

Vetëm kryqet e një kohe të egër
Si kallkanët në dimër galopojnë
Nëpër fushat e përgjumura të atdheut

## E TËRË DYNJAJA MENDON

Në këtë dhomë të bezdisshme
Dhe të pagjumë
Bashkëbanoj me vetmin time
E tërë dynjaja mendon
Se jam i vetëm

Le të mendojnë të verbëtit
Çfarë të dojnë
Unë kurrë në jetën time
S'kam qenë
Dhe s'do të jam i vetmuar

Përherë me mua ishte vetmia
Më ka përqafuar
Dhe ledhatuar si njeriu
Njeriun
Me duart e mishta prej erës

Kur binte shiu i ndryshkur
Nëpër kujtimet tona
Ne dënesnim në duet
Dhe i preknim mjegullat
E netëve të çafkave të verbëta

Kishim edhe çaste të mira
Kur era i tundte nëpër mendjet tona
Daullet e kujtimeve
Kurse ne nën urat e lumëbardhit
I mblidhnim grimcat e humbura
Të ëndrrave tona bonjake

## NGA FRIKA OSE NGA MOSDIJA

Kur një ditë
Do kthehem nga askund
E të mbërrij në mesin e juaj
Mbase edhe ju do jeni diku askund

Nëpër ledhet e historisë
I keni harruar gjymtyrët e rrugëve
U bëtë përrallë e enigmave
Duke jetuar nga lavdërimet

Sot  jeni duke bredhur
Nëpër gjurmët e juaja të shlyera
Vetëm gjëmat e kujtesës
Ju mbajnë gjallë

Nga frika ose mosdija
Si kanibalët dhunuat historinë
Ishit ushtarë të mbretërve pa fron
Që kurrë nuk abdikuan në mendjet e juaja

Vdisnit vetëm për të ju lavdëruar i huaji
Një pjesë të një gjymtyre
E varrosët diku në rërat e huaja
Kurse në atdhe s’patët vend për një kryq

## I SHKULTE FLOKËT E THINJURA TË ERËS

Njerëzit kalojnë rrugëve veshur
Me nga një pallto të zezë
Hijet e dyshimta davariten
Si retë e dehura
Nën kujtesën e fjetur zgjohen makthet

Zogjtë e metaltë fluturojnë kuturu
Prej një ane në anën tjetër të mendjes
Zbresin halucinacionet
Një nënë e moshuar
I shkulte flokët e thinjura të erës

Jashtë portave të heshtjes
Zhurmojnë bubuzhelët e një stine
E cila kurrë nuk u këndell nga shirat
Nëpër zgërbonjat e drurëve të kalbur
Fshihen çafkat e zeza të një stine

Ky dimër i acartë
Nuk i ngjanë dimrave të tjerë
Nga çatitë e mbuluara me kashtë thekre
Pikojnë si rrëshira
Trishtimet e netëve të ngrira

## ZËRI I TRISHTUAR I OAZËS

Si bishat e tërbuara
Ulërinë retë e plumbta
Ulërin edhe dendësitë e mjegullave
Një hënë nudo me flokët e shprishura
Si pa kokë vrapon nëpër shpirtrat e shirave

Gjelbërimi i etur
I përngjan kaktuseve të shkulur
Nga zëri i rërës së shurdhët
Dëgjohen thirrjet e gjyshërve
Një hardhucë e përgjumur
Bisedon me etjen e zhurit

Asnjë fjalë s'flasin milingonat
Përmbytja e shpirtrave
Edhe kësaj here ri përsëritet
Nga ringjallja e sfinksave
Tmerrohen rebelët e shkretëtirës

Aty këtu duken zvarranikët e rërës
Shkurret që ngjajnë me shpirtrat e zogjve
Sot duken si nuset e maleve
Zëri trishtuar i oazës
Sa duket i largët në këtë etje të madhe
Zëri i trishtuar i oazës

## KALIMTARËT E RASTIT

Në këtë natë të vonë
Dëgjohen pasthirrmat e erës
Kthej kokën mbrapa
S'dëgjohet asnjë lehje qensh

Lumi i qytetit tim
Gurgullon si zëri i çmendur i mëngjesit
Kurse këndesat
Akoma nuk i kanë zgjuar yjet e fjetura

Një njeri i dehur
Si përherë bisedon me kontejnerët
Shan dike ndër dhëmb
Mbase e mallkon edhe vetveten

Por përherë përsëriten mbrëmjeve të vona
Këto mizanskena
Kur lëshohen perdet e teatrove antike
Në shpirtin e mykur të natës

Nëpër telat e ndryshkura të rrymës
Uturinë një det i përgjumur
Kalimtarët e rastit
I fshehin kokat nën palltot e mjegullave

## NJË QUKAPIK I VERBËR

Mbrëmë njerëzit i dëgjuan thirrmat
E mjegullave
Dëgjuan dhe s’panë asnjë njeri

I hapën edhe dritaret e mbyllura
Çuditërisht
Era i mbyllte sytë dhe mendimet

Sërish nuk prajnë thirrmat
Çafkat e zeza
Fluturojnë mbi qiellin e uritur

Një copë mjegulle prej druri
Nga strofujt e meteorëve endacak
Çmendurisht i shkulte rrënjët e shirave

Sa e trishtë kjo natë e gjatë
Asgjë s’dëgjohet
Përpos zhurmës së shkuljes së drurëve

Një qukapik i verbër
Është futur në strofullin e lakuriqëve të natës
Dhe çukit pandërprerë çukit
Në përgjumjen e gjetheve

## ME ËNDËRRAT E TYRE TË BOSHATISURA

Kolonë gurësh të murrmë
Marshojnë qyteteve të humbura
Marshojnë si arinj të verbër
Një rrugë e gjatë sa jeta
Askund nuk ndalet nëpër trotuaret e zbehta

Por edhe askund nuk ka fund
Fundi i saj gjendet diku askund
Mbase edhe nuk ekziston një rrugë e tillë
Kurse njeriu
S'ka se ku të mbërrin në këtë zbrazëti

Ecin njerëzit me mollëza të zhubravitura
Ecin drejt përtejmes
E cila nuk ekziston askurrkund
Ecin me ëndrrat e boshatisura
Dhe me valixhet e zbrazëta prej kartoni

Kjo kolonë prej eshtrash dhe mishi
Ngjanë me drurët e kalbur
Lëvizë si bisha e sëmurë
Ecën pa asnjë shpresë për të nesërmen
Vetëm duart e ngjyrosura të hijeve të zbehta
Përshëndesin zogjtë e humbur endacak

## KJO STERRË E PADURUESHME

Përvajshëm dëgjohet zëri i largët
I një qemaneje
Qante edhe qemanexhiu
Kjo natë e gjatë s'paska asnjë rrugëdalje
Nga rropullitë e lisit të njomë
Pikon rrëshira e zezë

Nëpër kujtesën e mjegullave
Fluturojnë krakëllimat e korbave
Kjo sterrë e padurueshme
Që i përket vetëm djajve
Sonte qenka mishëruar
Me zërat e trishtuara të thikave

Po dënes edhe nata
Hapësira e pafund e horizontit
Duket e shprishur si flokët e plakave
Një tjetër diell i shëmtuar
Me rrezet shpatë po ngulitet
Në  trupin e mishit të njomë të kësaj nate

## HAJDUTË BIZHUTERISH

Pashë nëpër rrugë
Profet e gjeneral që rrinin tok
Hajdutë bizhuterish
Që ishin në gjendje të shkulin flokët e erës

Apostuj dhe vëllezërit e Judës
Duke pritur ndër sofër
Kafshatën e të varfrit
Si korbi i zi që e prite djathin e mykur

I pash edhe djajtë lakuriq
Duke zhveshur hajnisht
Nga shpirti i dërmuar i erës
Astarin e mirësisë

Çfarë s'pashë në atë zallamahi
Njerëz me nga dy gunga në shpinë
Që ngjanin
Me devetë e shkretëtirës

Prishtinë, 8 tetor 2014

## DO VEMI NJË DITË

Do vemi një ditë ta zgjojmë harresën
Ta zgjojmë mykun e kujtimeve
Nëpër shtigjet e udhëve
Ta mbjellim kujtesën
Se për ndryshe
Të përgjumurit nuk mbërrin askund

Koha është ta shqelmojmë sterrën
Vetëm njëherë nëse i hapim sytë
Kurrë më era
S'do të jetë në gjendje
Për t' i mbyllur me dyllë të verdhë
Dritaret e shurdhëta të kujtesës

Ju thashë se do vemi një ditë
T'i mbledhim ato pak dromca
Që kanë mbetur
Nën muranat e shembura
Edhe te ne nëpër skuta mjegullash
Duhet të çelin zogj trajtat e shirave

Me duart e saja të brymta
Po na ngufat ky gjumë i përdalë
Do vemi një ditë t'i zgjojmë burimet e fjetur
Sepse lisat e përgjumur nuk lëshojnë rrënjë
Në kujtesën njerëzore

## KËTA SHIRA TË RREPTË

Kur të ndalen shirat
Edhe nëse vonohem si çdoherë
Ti më prit atdhe
Mbase edhe kurrë nuk është vonë
Për tu kthyer njeriu në rrënjët e veta

Këta shira të rreptë
Këtyre kohërave të çmendura
Po i shkulin nga degët e mjegullave
Shpirtrat e vrarë
Të zogjve mërgimtarë

Po shemben çerdhet e mendjeve
Nëpër metropolet e huaja
Çdo kokërr pluhuri
Më duket një mal i dendur
Me trishtimin e jetës

Po pres jam në pritje e sipër
Lojën e shirave të çmendur
Domosdo dielli një ditë
Edhe për mua do buzëqeshi
Si një kërthi i posa lindur

## NJË ERË E FORTË PO FRYNË NGA KUJTESA

Kjo kafshatë e përditshme
Pa mëshirë po i gërryen muret e rropullive
S'përtypet dhembja me kaq pak fjalë
Mjegullat shpeshherë sjellin breshër
Nëpër faltoret e harruara
Nuk ka mbetur asnjë perëndi

Një kryq i mbjellë në kujtesë
Ka filluar të fishket si lulja
Sandalet e erës si anijet lugetër
Notojnë në përditshmërinë tonë
Kurse mbi shpirtin e plagosur të detit
Dëgjohen krakëllimat e yjeve

Edhe shirat na kanë harruar
Perënditë ikën përtej shtatë bjeshkëve
Koha e mjegullave veç ka lëshuar rrënjë
Nëpër varret e dhunuar
Kanë zënë fill e po kalben gurtë
Një erë e fortë po frynë nëpër kujtesë

## DIELLI I NGURTË DEHET SI MIKU IM LANI

Nëpër librat e vjetër
Takohem me parathëniet e pathëna
Një erë blu frynë nëpër fletat e pluhurosura
I verbon njomësit e drurëve

Ne ecim rrugëve të baltosura
Hapat tona ngjajnë me trokëllimat
E kuajve të egër
Dielli i ngrirë dehet si miku im Lani

Lulet çelin në qindra ngjyra
Por asnjë sish nuk e ka aromën
E vendlindjes së Uliksit
Sirenat dënesin mbi kepat e oqeaneve

Një grusht pritje premtojnë meteorët
Udhëtarët e vonuar
Hap pas hapi kalojnë si të verbër
Nëpër gjymtyrët e netëve të vonuara

Në këto  taverna të qytetit fantazmë
I parandiejmë hijet e padukshme
Mes tavolinave dhe njerëzve
Vallëzojnë si brirët e drerit pirunët e palarë

## PËR KË TË SHKRUAJ NË KËTË NATË TË VONË

Atë çast kur të duket se është bërë vonë
Ti vjen fshehtas
E troket në portat e mbyllura
Janë mbyllur edhe faqet e të gjitha letrave
Për kë të shkruaj në këtë natë të vonë

Brenda meje si nga shtambat
Derdhet një shi i çuditshëm
Nuk mejnë as lotët e bretkosave
Dalë nëpër rrugët e qytetit
I lexoj reklamat e dyqaneve të mbyllura

Aty këtu shoh ndonjë kalimtar
Duke shkelur nëpër fytyrën e zhubravitur
Të natës së dhunuar
Njerëzit kalojnë duke ecur me hapa të dehura
Nga ballkonet me drita të kuqe
Zonjat e bardha thërrasin trishtimin

Ecin edhe rrugët
Diku larg dëgjohet zëri i pikëlluar
I një qemaneje të vetmuar
Sa me afsh sterra i përqafon xixëllonjat
Kur në një varr të vetmuar
Ndize qirinjtë e vetme të pikëllimit

## ME QESHJEN E VIRGJËR TË GJELBËRIMIT

Një hije tejet e kërrusur
Ende pa kënduar gjelat
Kalon rrugicave të ngushta të qytetit
Edhe një bastun si një qen besnik
Ecën tërmal hapave të saja

Qepenat e mbyllur
I bëjnë me sy njëri-tjetrit
Nëpër pragjet e dyqaneve
Akoma flenë macet e rrugëve
Vetëm zëri i simitçiut
Për çdo menatë
I ngacmon shqisat e të shijuarit

Te kajsishtat e shtëpive të ulëta
Vesa e hershme lëshon shtat
Një zog i vetmuar si çdo mëngjes
Me qeshjen e virgjër të gjelbërimit
I lanë sytë e lëbyrtë të përgjumjes

## NGJANË ECJES SË KËTYRE MALEVE

Drurët e njomë të shpirtit
Me nga një copë alegorie në dorë
Ecin si të dehur nëpër histori
Parakalojnë nëpër varret e ushtarëve
Të njohur dhe të pa njohur
Më duket se po u përngjajnë gjyshërve

Ecja e tyre kishte një madhështi krenare
Ngjante ecjes së  këtyre maleve
Kur kollitej
Nga shpirtrat e gjetheve i pështynte
Të gjitha të ligat e kohës

Këta drurë sa shumë ngjajnë me parathëniet
E baladave të moçme
Edhe kur çmendet murrlani
Këndej pari
Nga secila degë pikon portreti i erës
Kurse nën shpirtin e gjetheve flenë alegoritë

Njerëzit dhe drurët e atdheut tim
Janë të ngjizur për këto male
Në shpirtin e secilit zgjohet
Një dashuri e paparë
Kur i dëgjojnë daullet e kushtrimit

## SA HERË QË KOLLITET NËNA

Ishe tepër i sigurt biro
Kur i tha lamtumirë
Gjërave të imta
Në gardhin e shtëpisë
E lë peng këmishën e arnuar
Dhe me një pallto të re e more dynjanë në sy

Ti vetë ike
Deshe të shndërrohesh në harresë
Letrat tona të hidhura
Trokisnin nëpër dyer pa adresë
Trokisnin nëpër portat e mbyllura

Motet iknin si kaprojtë brithyer
Kurse neve na zuri pleqëria e vonshme
Dimrat janë të gjatë
Dhe të egër
Këtu në Ballkanin e trazuar
Sa ora vdesin zogjtë

Ka çaste të tilla
Kur na vinë në gjumë disa hije të zeza
Po çfarë të bëjmë ne
Në këtë moshë kaq të shtyrë
Sa herë që kollitet nëna
Më bëhet se dikush po troket në derë

## ME KUFOMA TË NGRIRA

Zogjtë e ngrirë
Nëpër degët e thyera vrasin heshtjen
Dimri i sivjetmë
Paska veshur një këmishë të bardhë
Dhe duket se në ecje e sipër
Thua se i përngjan ndonjë spitali psikiatrik

Nëpër dhomat e mbushura
Me kufoma të ngrira
Kundërmon dita e plagosur
Një erë e rënd ngjyrë plumbi
Ankorohet në shqisat e të nuhaturit

Kolliten muret
Si të sëmurët nga tuberkulozi
Kolliten shtretërit e metaltë
Këto dritare të mëdha hapen
Vetëm njëherë në vjet
Kur dalin arkivolet e ngrira

Nëpër korridore të përgjumura
Vetëm bubuzhelët shohin ëndrrën
E lagështisë së mureve të çara
Me qindra vite
Dielli nuk paska hyrë nëpër këto dhoma

## NJERËZ TË ETUR DHE TË URITUR

Rrugëve të boshatisura
Takoj njerëz me sy të mbjellë
Kukulla prej druri
Dhe ato tjera nga silikoni
Shkojnë drejtë mermerëve të kuq
Secili e mbanë në dorë
Dhe në shpirt kryqin e vet

Ecin duke u përkundur trotuareve
Përkunden si ajri i tymosur
Nëpër imazhet e thyera
Prej siluetave të portokalltë të atdheut tim
Një ndjenjë e thellë
Si thika e topitur më ngulitet në tru

As krakëllimat e korbave sonte
Nuk bëzajnë
Nëpër varret e qytetit
Si kolonadat antike marshojnë arkivolet
Njerëz të etur dhe të uritur
Skutave të errëta bisedojnë me kontejnerët

## PËRBRENDA OXHAKUT

Nga një libër i vjetër
Me qindra vite i pluhurosur
Në raftin e kujtesës
I shkundi të gjitha shkronjat
Më pastaj ulem në kanapenë e kujtimeve
Dhe shkruaj një tjetër libër

Era troket
Pandërprerë troket si një zog i ngrirë
Nëpër xhamat e palara të dhomës
I hapi dritaret e mbyllura
Sa ora më largohen shkronjat e shkundura
Ikin nga dhoma ime e gjumit

Asgjë nuk më mbetet tjetër
Në këtë qetësi të llahtarshme
Përpos t'i përqafoj muret e lagshta
Përbrenda oxhakut
Që nuk është ndezur me vite
Dëgjohen si nëpër ëndrra
Uturimat e disa zërave asnjanëse

## KËPUCËT

Nëpër rrugët e Prishtinës
Ka çdo lloj gjurme këpucësh
Prej atyre të firmave më të njohura Italiane
Deri te tullumbat e lagura të Lulit

Ecin njerëzit
Parakalojnë edhe këpucët pas tyre
Shoh sandale hedhura në va
Që tunden si varkat e harruara
Nëpër detet e përmbytura

Ka çdo lloj këpucësh
Prej atyre që këndojnë
Serenatat e njohura Korçare
Deri te ato këpucë që fundosen
Nëpër fundet e baladave

Njerëzit dhe llojet e këpucëve
Në qytetit tim
Sa shumë i ngjajnë njëri- tjetrit
Ngjajnë sa që kur parakalojnë rrugëve
Në këmbët e njerëzve duken tejet qesharake

## NJË NATË E GJATË SI KJO

Sonte nuk paskan të ndalur tupanët
Mbase janë çmendur daullexhinjtë e dehur
Po i mëshojnë
E po i rrahin lëkurat e regjura të natës

Po thyhen brinjët e lakuara të erës
Të shelgjishtet
Po çelin disa lule të tjera
Që nuk kanë çelur asnjëherë në tokën tonë

Faltoret i ka zënë një tjetër lloj myku
Nëpër xhadetë e shtruara me rërë të kuqe
Dëgjohen kërcëllimat e qereve
Që bartin dhimbjen e një shekulli

Po bredhin këtyre rrugëve të përgjakura
Prej ushtarëve vrasës
Deri te gjeneralët dhe priftërinjtë pedofil
Po enden si lubitë sokakëve të dhunuar

Sonte nuk paskan të ndalur krakëllimat
E korbave të zinj
Një natë e gjatë si kjo
S’kisha dashtë të përjetoj edhe njëherë

## KOCKA TË RRJEPURA LOPËSH

Nëpër kontejnerët e qytetit fantazmë
Do të gjesh pashnik të vdekurish
Dhe fëmijë të braktisur
Nga një jetë e dështuar prej dëshpërimi

Kocka të rrjepura lopësh
Dhe lëkura të regjura kuajsh të mbytur
Nëpër kontejnerët e qytetit tim
I gjen të gjitha llojet e dizgjinëve

Këtu nuk vdesin kuajt në këmbë
Edhe nëse ngjan kjo vdekje
Të qeshurat nuk ndalen me vite të tëra
Qeshin edhe tablotë surrealiste nëpër mure

Nga sytë e pikturave herë pikon gjelbërimi
E herë një lloj ngjyre asnjanëse
Që lëvaret nëpër sytë e kalimtarëve
Të cilës askush nuk ia mësoi emrin

Prishtinë, 9 tetor 2014

# *Dritaret e verbëta*
# *Cikli i dytë*

## KUDO KOLLITET STINA PLAKË

Më është fundosur një dimër në shpirt
Edhe kokën nuk ma lë rehat
Shikoj qiellin
Askund s'shoh dritë
Shpirti lëngon qëmenatë

Një dëborë e ngrirë
Më ka zbritur mbi kokë
Qerpikët shndërruar janë në kallkan
Dimri më ka zënë ngushtë pa miq e shokë
Mezi kjo tokë gjallë më mbanë

Një erë e çmendur nga malet frynë
Si ushtarët e dylltë zbresin lisat
Stina stinën me dhunë e shtynë
Ky dimër i zi
Na i zbardhi plisat

Kudo kollitet stina plakë
Hedh pjalm e vrer nga vrimat e hundës
Po na e ngrin gjakun
Për çdo ditë nga pak
Që pikon nga maja e shpirtit dhe buzës

## VEÇ MURRLANI I EGËR S'BËZAN

Me një pashnik të bardhë
Fërfëlliza malet i mbulon
Një erë e acartë
Rrugëve të baltosura frynë
Një dre i plagosur shtigjeve vrapon

Kudo ka zbritur një dimër i ri
Mbi flokët e stinës
Mbjellë pjalm e dëborë
Kjo kohë na i gërryen zorrë e mushkëri
Mërdhinë eshtra shpirt e dorë

Në këtë natë të shurdhtë
Veç murrlani i egër s' bëzan
Drutë thyhen nëpër shtigje
E kërcasin si gështenjat në zjarr
Diku dike e vajton një nënë
Ah kur do të kthehet pranvera sa më parë

## NËN NJË ÇATI TË RRËNUAR

Një njeri dhe stoli i vetmuar
Në parkun e vjetër
Era gjëmon
Braktisur diku
Nëpër skutat e botës
Një kryq i ndryshkur
Mbi një kërcu të kalbur vajton

Sërish frynë era
Gjethet kalamenden vërdallë
Nën një çati të rrënuar
Shuhet një qiri
Përherë në këtë botë
Përsëritet e njëjta përrallë
Kur i vetmuar vdes një njeri

## PAMË SE SI LAHEJ NJË ZOG NË PLUHUR

Portat tona të mëdha dhe ato të vogla
Gjithmonë ishin të hapura
Shi zogjsh hynin e dilnin
Nëpër kujtesën e çatisë së kalbur

Nga gravurat e vjetra të kishës
Përjetuam zbritjet e ikonave
Dhe na habitën datat e çuditshme
Të rënies së perëndive

I kaluam të gjitha shtigjet e mundshme
Dhe atë të pa pamundshme
Mbi asfaltin e djersitur
Pamë se si lahej në pluhur një zog

Nuk u besuam ardhacakëve
U lënduan drurët e shkulur të maleve
Dhe vonë kuptuam se sa i rëndë qenka loti
Nën sytë e kaltra të statujave

Si sfinksi i rërës i thithëm
Rrezet e para të diellit
Diell tjetër nuk lindi më në qytetin tim
Një zog i bardhë fluturoi nëpër legjenda

## NË ATO KOHËRA TË MIRA

Ishte koha e dyndjeve
Ne rendëm nëpër shpirtrat e ullishtave
Ashtu na mësuan pleqtë
Se vetëm atëherë nëse ndjejmë
Ngjizjen rrënjëve
Mund të jetojmë aq sa jeton një trung ulliri

Dhe besuam një gur graniti të kuq
E bartëm si relikte në shpirt
E bartëm duke i kapërcyer malet
Aq shumë ishim afër perëndive
Sa që i ndjenim në qeniet tona
Ledhatimet e panumërta të mjegullave

Në ato kohëra të mira
Shirat ishin të çmendura
U përngjanin kuçedrave
Çdo stërkalë në rrugëtimin tonë
Të gjatë
Na dukej si ledhatim perëndish

## NJË NATË ME YJE PRUSH

Ishte natë
Dhe hëna si një mollë e pjekur
I spikaste degët e dëllinjave
Një natë me yje prush
Dhe ne shikonim
Kah ndizej qielli i ngrirë

Zjarri nuk ngrohte sa duhet
Shpirtrat e meteorëve endacak
Nga buzët e shtrydhura të yjeve
Pikonin kallkanët në pranverë
As zogjtë e trishtuar
Nuk mundën të fluturojnë më

Nëpër hapësirën e përflakur
Prej psalmeve të ngrira
Filluan të pikojnë lotët e engjëjve
Dhe ja si nga ndonjë legjendë
Nga nëntoka dolën kalorësit e apokalipsit
Nga një tmerr i paparë
Hingëlluan potkonjtë e kuajve

## NUK PUSHOI VAJI I ZANAVE TË UJIT

Furtuna nuk ishte e tejdukshme
Ditën e mori pushka
Një gjëmë
Si një jehonë e lig zbrite nga majat

Yjet nuk flinin
Hëna e përgjumur tundej si një varkë
Në dallgët e çmendura të Lumëbardhit
S'ndaleshin as serenatat e lagjeve të varfra

Buzë Drinit të bardhë
Dëgjohej ushtima e turbullirës së ujit
Pranë shelgjishteve të shkulura
Si furtunë deti rritej frika për të nesërmen

Gjatë tërë ditës
Nuk pushoi vaji i zanave të ujit
Nëna ime nuk pushuan as të lehurat
Në Gurtë e Hasit jehuan kambanat

## PËRHERË FLENË ME SY TË HAPUR

Në shpirtrat e maleve tona
Kullat kanë sy e vesh
Dëgjojnë kah uturijnë mjegullat
Por deri në përsosmëri
E njohin artin e heshtjes

Përherë flenë me sy të hapur
Kur duhet të shohin në sytë e këtyre burrave
Kurrë nuk u turbullohet pamja
Askush si këta malësorë
Nuk ngjajnë me zogjtë e shenjtë

Për sytë dhe veshtë e këtyre njerëzve
S'ekziston as lartësia
E as largësia e pamat e yjeve
Shohin me sytë e shqiponjës
Dhe dëgjojnë me veshtë e skifterit

## DRITARET E VERBËTA

Sonte nëpër xhamat
E dhomës së verbët
Si dallgë deti
Përplasen krahët e një zogu
Përplaset edhe era e shthurur

Nga një libër i vjetër
Trishtueshëm i shkundi
Trishtimet e një jete
Shkundi edhe vetveten
Nga një përgjumje e përdalë

Një zog me krih të thyer
Noton mbi sterrën e plumbtë
Dritaret e verbëta
As nuk hapen e as nuk mbyllen
Qetësia po i çmend mushkonjat e verdha

Po më mërdhinë duart
Nga çatia e rrënuar
Si rrëshira e zezë pikon dhembja
Shikoj nëpër zbrazëtirën e tejdukshme
Asnjë flutur sonte nuk hyri në dhomën time

## NUK DI A T'I SHKRUAJ NJË LUTJE ZOTIT

Nuk di a t'i shkruaj një lutje Zotit
Apo t'i urdhëroj
Edhe nëse bëjë këtë
Kot do ta kem
Zoti im nuk di shqip
E as unë s'e njoh gjuhën e tij

Sa larg jemi njëri - tjetrit
Kur s'dimë të flasim
Unë nuk e njoh pantomimën
Gjuhët e tjera
S'pata kohë t'i mësoj
Ma ndërprenë shkollimin që në rini

Ishte një dimër i zi atëherë
Edhe Zoti e harroi popullin tim
Nga qielli yjet
Na gjuanin me plumba
Kurse nga toka
Na shurdhonin dhe po na shurdhojnë
Uturimat e tankeve

## I ZGJASIM DUART NËPËR THELLËSIRA

Nuk di çastin kur u takuam
Ishte herët
Ose ishte bërë tepër vonë
Por ne u pamë
Në vorbullën e jetës
I pamë edhe anët e tjera të botës

Frynte një stuhi e acartë
Ishte ose nuk ishte dimër
Ne të dy ishim
Diku në mes të një stine
Pa kurrfarë gjinie
Nuk ishte as stinë asnjanëse

Stuhia nuk ndalej
S'ndalen as sot rrapëllimat e qepenave
Mbase as ne nuk dimë
Se ku jemi
I zgjasim duart nëpër thellësira
Dhe si të verbër mbytemi në cekëtinë

## ENDTE NJË TJETËR RRJETË

Rastësisht i shtrimë duart
Prekëm asgjënë
Përtej një lumi të çmendur
Djajtë lahen lakuriq

I pamë edhe lakuriqtë e natës
Zëri i shpellës më dukej i njohur
Në sterrën e padukshme
Një merimangë thurte një rrjetë trishtimi

Aq shumë i hapëm sytë
Sa që na verboi errësira
Mbase me miliona vjet drite
Drita kishte ikur nga kjo shpellë e shpirtit

Një rrjetë e lagshtë merimange
Ulur në prehrin e erës
Endte një tjetër rrjetë
Për mikun e padukshëm të natës

## KJO GJUHË E LASHTË E MALIT

Jam në hall me vetveten
Si të flasë me drurët
Kjo gjuhë e lashtë e malit
I njeh parathëniet e të gjitha lisave

Para këtyre drurëve
Këndej pari sillej dikush tjetër
Era u bënte shoqëri mjegullave
Kur dënesnin shirat e hidhur

Kishte edhe njerëz këndej pari
Gatuanin bukën e drurët
Merrnin frymë nga rrënjët e lisave
Dhe buzëqeshnin si gjelbërim i barit

Prishtinë,10 tetor 2014

## NJË NJERI DOLI NGA PARZMA E DHEUT

Bënë vapë e padurueshme
Më duket se është koha t'i thërrasim shirat
Frymëmarrja e kohës po shpejtohet
Nën pemët e prera
S'pushojnë më zogjtë e plagosur

Më kujtohet kur isha fëmijë
Me një copë llamarine i thërrisnim
Të reshurat
I thërrisnim kur vonoheshin stinët
Toka kishte etje të madhe

Nga dritaret e çative të rrënuara
I spikasnim lotët e drurëve
Qanin edhe gjethet
Kjo tokë kishte etje të madhe
Sa që nga shpirti i saj dilte një flakë e gjelbër

Erdhi edhe koha e daulleve
Nga të katër anët e dheut jehuan kambanat
Burrat lajmëruan për ardhjen shirave
Një njeri doli nga parzma e dheut
Dhe paralajmëroi kushtrimin e lirisë

## PRAPA DYERVE TË MBYLLURA GALOPON ERA

Sa gjëra të pavlera paska në këtë dhomë
S'kam ku ta rrufis as kafenë e mëngjesit
Si çdo ditë edhe sot
Më herët më zgjoi këndesi i dehur

Dielli akoma nuk kishte lindur
Te kajsishtat dëgjohej lehja e qenit
Mos vallë era troket në derë
Ka kohë që nuk janë hapur këto porta

Sërish dëgjohet lehja e shthurura
E një mëngjesi të hershëm
Të trokiturat akoma nuk ndalen
Prapa dyerve të mbyllura galopojnë erërat

## DERISA NGA DRURËT E ÇATISË

Më kujtohet o fare mirë më kujtohet
Kur nëpër dhomat e fëmijërisë
Grindeshim për gjëra banale
Për një palë çorape të arnuara
Me javë të tëra
Nuk pushonin ngacmimet

Ishim fëmijë ngarkuar me brenga
Kurse sot kur u rritëm
S'kemi më me kë të grindemi
U bëmë pikë e pesë
Nëpër dhomat e boshatisura
Fshehtazi dënes me mallëngjim
Fëmijëria e jonë e uritur

Ku sot nëpër ato zbrazëti
Frynë erëra të çmendura
Nuk ndalen
Derisa nga drurët e çatisë
Si rrëke lumenjsh derdhen ëndrrat
Pikojnë në shpirtin e një nostalgjie
E cila asnjëherë nuk shërohet

Ishim të vegjël
Tepër të vegjël sa që nga duart tona
Të njoma
Për çdo ditë shtrydhnim varfërinë
Një kafshatë buke na dukej si një mal
Derisa neve na zinte gjumi
Me një uri të paparë

## QAJNË EDHE SHIRAT

Si avion të prishur
Për çdo mëngjes zogjtë e sëmurë
Ulen mbi shpatullat e mjegullave
S'reshtin as shirat imcak
Po bien si gjethet e një stine të vrarë

Nëpër qiellin e plumbtë të atdheut tim
Fluturojnë avionë të çmendur
Në tokën e kallur
Nga dhembjet e plagëve
Nuk ndalen
As britmat e trishtuara të nënave

Një dre i plagosur qëndron mbështetur
Për trungun e një druri të moçëm
I fërkon brirët e thyer
Thellë në shpirtin e çarë të tokës
Dëgjohen britmat e nëndheshme

Veç ka filluar shkundja e gjetheve
Nëpër çdo sukë ose shtrojerë të zhuritur
Shoh se si qajnë kryqet pa zot
Qajnë edhe shirat
Mbi shtatin e plagosur të atdheut

## JAM LODHUR

Jam lodhur
Dua ta mbështes kokën mbi dhembjen time
T'u përngjajë mjegullave kur flenë
Në një shtrat krijuar prej shiu

Qe njëmijë vjet jam në udhëtim e sipër
U njoha me të gjitha detet e Uliksit
Në udhëtimet e mia të gjata
S'lashë brigje pa i shkelur

Jam lodhur më
Nuk më mbajnë as këmbët
Ku ta mbështes kokën dhe dhembjen time
Kjo udhë e gjatë përfundimisht më dërmoi

## NGJAJNË ME HINGËLLIMAT E KUAJVE

Njerëzit përherë rendin
Rendin diku deri në pafundësi
Nëpër skutat e dynjasë
I ndjekin mirazhet
E fluturave të mjegullta

Nëse takohen ndonjëherë me vetveten
Diku në fund
Të ndonjë udhe të gjelbër
Shndërrohen në sfinksa prej rëre

Zërat e tyre ta pa artikuluar
Ngjajnë me hingëllimat e kuajve
S'ndalen së renduri as lehjet

Hingëllojnë edhe potkonjtë
Hingëllojnë si shollat e këpucëve
Edhe mëgojëzat
Rrugët janë të gjata
Kurse rendjet askurrë s'kanë pushim

Vonë kuptova që secili njeri
Rend pas kryqit të vet të mbjellë
Diku nëpër ledhat e kujtesës

S’ndalet askund
As për ta shuar etjen
Kjo etje e madhe pas rendjes
Nuk paska të sosur në jetën e njeriut

## KUDO ACAR NË PEMISHTET E NGRIRA

Dhe dolëm të shëtisim
Mbi gjethe e fishkura të vjeshtës
Lartë në degët e gështenjave
Dëgjohej si asnjëherë më parë
Cicërima e zogjve të harruar

Një njeri i kishte lënë peng
Ëndrrat e vjetra dhe ato të reja
Te degët e thyera të kujtesës
Me mallëngjim
Këndonte një kanarinë

Këndonte edhe vjeshta
Baladën intime të një stine
E cila kurrë nuk u këndellë
Ja pra pas kësaj vjeshte
Shumë shpejtë ia behu dimri

Kudo acar në pemishtet e ngrira
Vetëm një zog i trishtuar
Kërcente prej një dege në tjetrën
Kërcente si ketri i egër
Në gjoksin e qarë të dimrit

## HËNËZAT KISHIN AQ SHUMË URI

Brenda meje një hapësirë e paharruar
Varkat  e vetmuara
Përjetojnë përmbytjen e dallgëve
Ky shi imcak i kësaj vjeshte
Qenka më i mërzitshëm se çdo sëmundje

Herë përgjumet e herë zgjohet
Në ullukët e një tjetër kohe
Një ditë shndërrohet në breshër
Kurse ditën tjetër i përngjanë
Flokëve të mia të thinjura

Ka kohë që nuk isha vetvetja ime
Nëpër shpirtin tim galopuan kuajt e egër
Asnjë palë mëgojëze nuk mbeti te kroi
Mbas vdekjes së mbathtarit
Potkonjtë i përpiu e zeza

U davaritën edhe retë e plumbta
Ngrysja e qiellit
I ngjante dallgëve të çmendura të detit
Hënëzat kishin aq shumë uri
Sa që e përpin edhe kepin e mirë
Në shuplakat e zhubrosura të detit

## THËRRASIN E KËLTHASIN

Nga diku larg shumë larg
Dëgjoj zërin tim
Një kohë e ikur më bënë me dorë
E dora dridhet në ajrin e tymosur
Mbase edhe kërkon shpëtim

Edhe zërat e tjerë
Dëgjohen thua se mbinë në ndonjë humnerë
Thërrasin e këlthasin
Por kot janë të thirrurat në këto çaste
Druri i djegur s'paska asnjë vlerë

Sërish nuk mejnë të thirrurat
Nga një thellësi e pamat shpërthejnë jehonat
Ulem pranë disa librave të vjetër
Dhe me padurim i shfletojë
Epitafet e kronikave të harruara

Nëpër korridorin e errtë
Nata shkel mbi xhamat e thyera të pasqyrës
Askund dritë në fund të tunelit
Hijet e tunxhta
Trokasin në dritaret e mbyllura

Një njeri me hapa të rënda
Shkel mbi rropullitë e heshtjes
Nuk bëzajnë as muret e lagshta
Kjo qetësi vdekjeprurëse
Sonte sillet vërdallë mbi kokën time

I Afrohem lagështisë së mureve
Sterra i kreh flokët e shprishura të natës
Një lakuriq i verbër
Troket mbi xhamat e thyera të pasqyrës
Asnjë hije nuk i hap dyert e shkyçura

## TË PRITE DIKU NË FUND TË DHOMËS

Më duket se kot e shtrove tavolinën
Edhe qirinjtë po ashtu për së koti i ndeza
Ti nuk u duke në dhomën time
Vetëm një hije e verdhë
I mbulonte qepallat e dritareve

Pranë tavolinës si një lule e posa çelur
Rinte fotografia e jote
Vetëm një copë letër dhe asgjë tjetër
Fotografia dhe një çast i së kaluarës
Ngjitur për një copë celuloidi

Edhe macja ime kjo mikesh besnike
Të prite me padurim
Të prite diku në fund të dhomës
Ti e di fare mirë se si të mbështillej
Këmbëve të tua
Dhe i lëpinte sandalet e kuqe

Natë një njeri duke pritur
Dhe një qiri i ndezur
Presin një dritë e cila me gjasë
Sonte i paska humbur të gjitha rrugët
Nata qiriu i ndezur dhe pritja
Sonte në trio këndojnë një serenatë të vjetër

## KËSHTU NGJAU EDHE ME YJET

Çfarë nuk janë në gjendje
Të bëjnë njerëzit
Sa ora shpikin njeriun e shenjtë
Ose ushtarin vrasës

Më thanë se një ditë një kalë i zi
Vraponte pas mjegullave
Dhe kurrë më edhe njëherë
Nuk zbriti në tokë

Kështu ngjau edhe me yjet
Një natë kur hëna dukej e plotë
U fundosën në shpirtin e detit
Dhe tani u bëjnë dritë gjallesave nënujore

Të njëjtat fjalë u dëgjuan edhe për njerëzi
Në një agshol pa lindur dielli
Shkuan diku dhe kurrë më hija e tyre
Nuk bredhte nëpër qytete netëve të vona

## DUKE I SHIKUAR GURTË E VJETËR

Kjo ngjarje e madhe
Me siguri u ka ndodhur edhe të tjerëve
Sa herë që kaloj pranë varreve
I përshëndes eshtrat fosforeshente
Që më duken
Nga këndvështrimi im
Si varret e elefantëve

Nëse rastësisht jam i lodhur
Më së miri pushoj
Duke i shikuar gurtë e vjetër
Dhe duke i lexuar epitafet
E varreve të panjohura
Të cilëve
As që u dihet koha e lindjes
As edhe e vdekjes

Nganjëherë pushoj
Nën aromën e blirit që i ngjanë
Aromës së atdheut tim
Kështu që kënaqem deri në ekzaltim
Duke thithur nga shpirti i gjelbërimit
Aromën dhe duke i lexuar epitafet

## OSE NE TË GJITHË ISHIM NJË DIMËR

Sonte më unë nuk jam vetvetja ime
Duart e mia të kallkanta
Përqafojnë erën e ngrirë të përroit
Një vërshim i çmendur
Gurgullon në mendjen e rrapit

Më duket se iku dimri
Por kjo pranverë e acartë
Po i mërdhinë lastarët e ullinjve
Ka kohë që nëpër këto fusha
Ende nuk kaloi dielli

Ne akoma nuk kuptuam
Athua ishte dimri
Sivjet këtu
Ose ne të gjithë ne u bëmë një dimër
Kur stina
Ëndërronte të ndërroj gëzofin
Me një pallto të gjelbër

Prishtinë, 11 tetor 2014

## AH KUR ISHA I RI

Qëndroj mbi një trampolinë
Dhe kthej kokën mbrapa
Shoh se paska ikur koha
E një kohe të bukur
Asnjë mëllenjë e kuqe
Nuk këndon në shpirtin e bozhurit

Kur isha i ri
Ah kur isha i ri
Vetëm një poet rebel
Mund të krahasohej me mua
Unë kurrë nuk besoja
Se do të plakem një ditë kaq shumë

Po më dridhet dora e majtë
Po ashtu edhe këmba e djathtë
Kur isha i ri dikur
Ah kur isha i ri
Mali dridhej nën këmbët e mia

Sot kam mbetur një grusht eshtra
Në çdo ndryshim kohe
Te unë ngjallet një meteorolog prej mishi
Në mëngjes herët
Dhe në mbrëmje vonë
Ndjej ultimatumin e reumës në eshtra

# *Tinëzisht rrotullohen zaret e fatit*
# *Cikli i tretë*

## BRENDA MUREVE TË KUJTESËS

Mendimi im si një hyjni shpërfaqet
Në portretin e erës
Brenda mureve të kujtesës
Si nëpër baladat e lashta
Kalërojnë kalorësit e rrufeve

Një shtjellim i paparë prej mjegullave
Davaritet në mendjen time
Herë ikin e herë kthehen
Yjet e fikur të një nate
Në çerdhen e mendjes

Unë pres
Presin të gjithë ardhjen e një shkëndije
Lartë mbi kokat e yjeve
Si oreol vezullues
Mbinë një ikonë e paçmueshme

Në të katër anët e qiellit
Dëgjohen si në ndonjë kor madhështor
Zërat e pavdekshme të yjeve
Këndon
O sa bukur këndon qielli
Mu ashtu
Siç këndonte dikur Vaçe Zela

## SHPËRDRIDHET NJË HISTORI E HARRUAR

Sonte dua të dehem me natën
Me yjet
Që ngjajnë me kalorësit e egër
Vrapojnë prej një ane
Në anën tjetër të hapësirës

Kjo botë në miniaturë
Ka hyrë dhe banon në syrin tim
Me më ta ngrehi dollinë
Kalorësit nuk ndalen të marrin  frymë
Kurse yjet janë shumë larg nga tavolina ime

Mbi degët e lakuara të pjergullës
Lëvaren gotat e mbushura me verë
Dehen edhe rrënjët e tokës
Me bukurinë e kësaj nate
Dehen edhe perënditë

Sonte si asnjëherë më parë
Qante nata ime
Lotët e hënës derdheshin rrëke
Nëpër gjymtyrët e kësaj gote të dehur
Shpërdridhet një histori e harruar

## E NJOHA EDHE KRYQIN TIM

Ecja ime vertikale
Nuk u ngjanë atyre njerëzve
Që në asgjë s'kanë besim
Unë kaherë e njoha vetveten
E njoha edhe kryqin tim

Asnjëherë nuk adhurova
Asnjë perëndi
Pak si shumë i desha zotat e mi pagan
Ata kurrë në jetë
Nuk bënë asnjë krim
Te njeriu i cili anën e askujt s'ia mbanë

Unë vetëm desha thjesht
Të jem një njeri
Kurrë të mos dallohem për të mirë
Ose për të keç nga askush
Zotat u takojnë vetëm atyre
Që s'kanë mëri
E në shpirtin e fjalës s'bartin prush

## DUKET MË I MBRAPSHTË

Nga një libër i vjetër
I shkunda germat e një kohe
Parasysh mu paraqitën
Protestat e arkeologëve
Zanoret dhe bashkëtingëlloret
Nuk mejnë
Kjo grevë urie
Po ulërin në rropullitë e tokës

2.

Asgjë më nuk gjendet si duhet
Në vendin e vet
Hijet më nuk bëjnë hije
Nga pemët e shartuara me gjymtyrë njeriu
Pikon loti i hidhur i Hyjit
Pikon edhe trishtimi
I një beteje të humbur

3.

Kuajt dhe kalorësit sërish hynë
Në beteja të reja
Luftërat nuk ndalen asnjëherë
Në tokën tonë
Ky Ballkan i çuditshëm si çdoherë
Duket më i mbrapsht
Se sa që ishte ai Ballkani tjetër paraprak

## NJË STINË ASNJANËSE

Një derë e hapur
Nga drurët e të cilit mbin një fjalë e bukur
Që i pret
Dhe i përcjell miqtë

Nën çatinë e vjetër
Përherë ndalen zogjtë
Era i këndon psalmet e ndaluara
Të një tjetër kohe abstrakte

Pemët në kopsht
Përkulen deri te rrënjët
Dhe nga freskia e plumbtë
Thithin kujtimet e disa luftërave

Më tej te shelgjishtet
Një stinë asnjanëse
Parakalon me tullumbat e Lulit
Duke recituar poemën e mjerimit

## MBI NJË ARABA TË VJETËR

Në një dhomë të akullt
Një njeri pa jetë dhe një arkivol
I hirtë
Brenda mureve të ngrira
Një ëndërr që nuk e sheh askush

Te një mollë e tharë
Vdiq gjethi i fundit
Vjeshta sivjet
Më herët e kafshoi verën
Dimri ia behu papritmas
Me një qefin të bardhë

Nëpër rrugicat e ngushta të qytetit
Si potkonjtë trokëllijnë nallat e drunjta
Mbi një araba të vjetër
Me tërë trishtimin e një stine
Kthehet dimri i kaluar

## TINËZISHT RROTULLOHEN ZARET E FATIT

Ecim nëpër vetminë e qytetit
Hapat mbështjell me pasione të panumërta
Si hajdut nate
Fshihen pas lehjes së një qeni endacak

Nëpër kafenetë e mbyllura
Tinëzisht rrotullohen zaret e fatit
Ky rulet xhepi
Për çdo natë nëpër lokalet e pista
Kafshon nga një shpirt të lënduar

Kalldrëmeve të rregulluara për merak
Bredhin hapat e lehta të maceve
Vetëm një shi idhnak
Pandërprerë rrjedhë ullukëve të vjetër
Nëpër qepenat të mbyllura troket veriu

Që nga larg mëngjesi i zgjatë duart
Me hapa të dyshimta
Shkelë mbi veladonin e sterrës
Në brendinë e qytetit me kronika të zeza
Akoma ëndërrojnë faltoret e përgjumura

## MARSHOJNË MIQTË E MI USHTARË

Marshojnë miqtë e mi ushtarë
Ecin nëpër natë të shurdhtë
Diku pas shpine
Kanë lënë peng nga një copë ëndrre
Turtujt e natës i ngjajnë lakuriqëve
Vetëm xixëllonjat  e kuqe
Ua hapin
Dhe ua tregojnë rrugën

Ecin nëpër natë
Marshojnë miqtë e mi ushtarë
Depërtojnë nëpër shpirtin e sterrës
Për ta arritur qëllimin
I pret një rrugë e gjatë deri në atdhe
Një udhë e gjatë deri në liri

Ecin pa u ndalur askund
Marshojnë miqtë e mi ushtarë
Secili kalon nëpër dhembjen e vet
Por gjithsesi ata s’ndalen
Ecin deri në fund
Nata është e gjatë sonte
Diku në mbarim të rrugës i pret liria

## ME RROPULLIT E TË GJITHA LLOJEVE

Në qytetin tim ndalen trenat e panjohur
Askush nuk di
Se ku shkojnë natën të ngarkuar me dyshime
Bartin mallra nëpër qytetet
E të gjallëve dhe të vdekurve

Tasa konservash e peshk të ngordhur
Me rropullitë e të gjitha llojeve
Hingëllojnë vagonët
Makina vjell një tym të dendur
Fërshëllima i verbon vezët
Që akoma s'kanë çelur zogj

Ora e vjetër e stacionit
Në heshtje qëndron e varur
Për një dru të kalbur
Secili tren pa orar kur kalon këndej
Merr diçka nga dhembja e binarëve
Nata e ndryshkur shtrihet
Nën dy paralele shinash që s'takohen askund

Prishtinë,12 tetor 2014

## ASGJË SONTE NUK QENKA NDRYSHUAR

Këto kryqe të ngulura në tokë
Ngjajnë me murgjit
Që i kanë humbur orientimet në jetë
Për çdo natë
I ngacmon një kollë e thatë

Nëpër qiparisat e dehur fshikullon
Një erë e ftohtë
Dora e rënd e hënës mbështetet
Mbi shpatullat e mia të lodhura
Dhe sërish
Nuk ndalen kollitjet e natës

Gjumi i rëndë i gështenjave
Mbështetet mbi shpatullat e drurit të prerë
Nata e dehur
Kolovitet rrugëve qorre
Asgjë sonte nuk qenka ndryshuar
Si nëpër një ëndërr të keqe
Përsëriten ngjarjet e një nate që s'harrohen

## VDESIN EDHE VETË KRONIKAT

Do e fsheh këtë kronikë
Nën këtë gur
Ose në ndonjë mur
Që di të heshtë si guri
Kur të teket
Ti shkundi librat e vjetër
Shkundi të mos dremisin netët e dehura

Mes faqeve të pluhurosura
Mund t'i gjesh kronikat
E të gjitha llojeve
Prej atyre të zeza
Deri te ato të bulevardeve
Me qindra ngjyra

I gjen kronikat për njerëz të zakonshëm
Që i shikojnë vetëm punët e veta
Dhe për ato gra të përdala
Që kakarisin si pulat e egra
Netëve të vona
Dhe të shthurura deri në asgjësim

Shfletoj kronikat fillikat
Ku fshihen lindjet
Dhe vdekjet e shpeshta të njerëzve
Me anamneza të dyshimta
Vdesin edhe kuajt
Me mëgojëza të sermta në gojë
Vdesin edhe vetë kronikat

## RUFETË E PARESHTURA I KANË SHALUAR KUAJT

Sonte mua edhe valixhen time
Tok me vetminë e kësaj nate
S'po e zënë dritaret  e erës

Si një jehonë e tej largët
Nga diku prapa shpine dëgjohen
Fërshëllimat vetmitare
Të trenave të shurdhëta

Asnjë udhëtarë nate
Në këtë stacion mendimesh
Paskam humbur kot
Nëpër xhepat e mia të arnuara

Boçat e orës me vite të tëra
Nuk e ndalin tiktakun
S'ndalen as të trokiturat e shiut

Një njeri i moshuar
Dhe një qen endacak
Qëndrojnë mbështetur mbi një bankinë

Sterra kalon ngarkuar rrugëve
Pa reshtur me valixhet e vjetra të natës
Kalojnë edhe hijet e zeza

Nga qielli i pafund
Dëgjohen zërat e pa artikuluar
Të meteorëve

Rufetë e pareshtura
I kanë shaluar kuajt e egër
Trokëllimat e pandërprera ulërin
Ulërinë hapësirat e paanë
Nëpër shpirtrat e thyera të mjegullave

## ÇDO KUSH DO MË NJIHTE SE JAM SHQIPTAR

Po të isha edhe në fund të botës
S'mund të jem asgjë tjetër
Përpos një imazh i bardhë
Që i përngjan
Majave të Sharrit me qeleshe

Për këtë plis prej dëbore
Nuk ka askund në botë
Acar as dimër
Edhe mbi kokat e kardinalëve
Posedon një ndjenjë krenarie

Po të isha edhe në fund të botës
Në mesin e njerëzve
Më krenarë
Me këtë bardhësi shpirtërore
Çdokush do më njihte se jam Shqiptar

## DIKU NË SFOND TË PASQYRËS

Shikohem në pasqyre
Fytyra ime po ajo fytyrë e djeshme
Ngarkuar me të gjitha të ligat e botës

Asnjë ndryshim metafizik
S'ka ndodhur mes rrudhave
Dhe mureve të lagshta të dhomës

Diku në sfond të pasqyrës
Po ngjajnë gjëra të çuditshme
Edhe sot erërat po frynë mbrapshtë

Po kalojnë po ata lumenj të furishëm
Duke bartur mbi shpatullat e ujit
Dengje drurësh të shkulur nga shpirti i tokës

Edhe disa pamje të tjera fantazmagorike
Nuk e kanë ndryshuar shtratin e lumit
I cili po i përngjan devesë së verbët

Ndoshta edhe të nesërmen
Po e njëjta pasqyre do më shikoj
Pa kurrfarë ngurrimi drejtë në sy

Çfarë ironie e llahtarshme
Dhëmbët e palara të amalgamës
Zgërdhihen thinisht
Me portretin e papërfunduar të ditës

Prishtinë, 13 tetor 2014

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

# BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. **“Bajraktarët e vatanit”,** poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010

32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012
47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12

48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012

64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 **“ Ky def prej hëne”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Përfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013

80**. "Refrene yjesh",** Poezi, Shtëpia botuese "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2013
81. **"Te delta e mjellmave",** Poezi, Shtëpia botuese "Fahri Fazliu", Kastriot- 2013
82.**"Rinjohja",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2013
83**."Diku në fund të një fillimi",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2013
84**."Makthi i hijes",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-" Fahri Fazliu"Kastriot, 2013
85.**"Një zog prej uji",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"- Kastriot,2013
86**."Asnjë fjalë nuk frymon",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014-
87**."Daullet e një nate",** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve "Fahri Fazliu"-Kastriot 2014
88**."Sytë e gurtë të erës",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
89**."Kur dehen perënditë"** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"-Kastriot -2014
90. **"Fjetëm njëqind shekuj"** Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"-Kastriot ,2014
91**."Krakëllimat e natës",**Poezi, Shoqata e shkrimtarëve "Fahri Fazliu"-Kastriot, 2014
92. **"Ndjekësit e enigmave",** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"-Kastriot -2014
93. **"Atdheu i paçmuar**"Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-" Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
94**."Psalm i harruar ",**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"Kastriot 2014

95,”**Për kë po bie moj kambanë**”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. **“Mbi flokët e ullukëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. **“Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e** Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98**. “Loti i gotës së dehur”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99**. ” Stina asnjanëse”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. **“Dëneste bashkë me erën”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. **“Druri i pikëlluar**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. **“ Një grusht dashuri”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. **“Lëreni zërin tim”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. **“Shi në qytetin tim”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
105. **. “Si trenat e verbër ” ,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. **“Zjarri i malli tim ”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
107 **. “Kur teshtinë era** ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
108. **“Mbi shpirtin e erës pagane ”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
109. **“Nëpër gjymtyrët e mjegullave** ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

110. **”Ajo nuk erdhi sonte”** Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
111. **“Një hënë e zhveshur”,**Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
112. **“Nëpër plasaritjet e mureve”,**Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
113. **“Mes telave gjembor ”,**Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
114. **“Të vizatosh një zog në mur”,**Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
115. **” Nuk flenë as kuajt e dehur”** Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
116. **”Fluturojnë zogjtë e verbër ”** Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
117. **“Një shi prej bryme”** , Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
118. **“Në prehrin e pemëve”** , Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
119. **“Zëri i largët i shiut ”** , Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
120. **“Yjet e ngrira të kujtesës”** , Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
121. **“ Thirrmat e hijeve”** , Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015
122. **“Dritaret e verbëta”** , Poezi, Shtëpia Botuese “Trend” Prishtinë, 2015

# PËRMBAJTJA

## Një erë e fortë po frynë nga kujtesa
## Cikli i parë

Makthet e netëve pa gjumë ..... 15
E tërë dynjaja mendon ..... 17
Nga frika ose nga mosdija ..... 19
I shkulte flokët e thinjura të erës ..... 20
Zëri i trishtuar i oazës ..... 21
Kalimtarët e rastit ..... 22
Një qukapik i verbër ..... 24
Me ëndrrat e tyre të boshatisura ..... 25
Kjo sterrë e padurueshme ..... 26
Hajdutë bizhuterish ..... 27
Do vemi një ditë ..... 28
Këta shira të rreptë ..... 29
Një erë e fortë po frynë nga kujtesa ..... 30
Dielli i ngurtë dehet si miku im Lani ..... 31
Për kë të shkruaj në këtë natë të vonë ..... 32
Me qeshjen e virgjër të gjelbërimit ..... 33
Ngjanë ecjes së këtyre maleve ..... 34
Sa herë që kollitet nëna ..... 35
Me kufoma të ngrira ..... 36
Njerëz të etur dhe të uritur ..... 37
Përbrenda oxhakut ..... 38
Këpucët ..... 39
Një natë e gjatë si kjo ..... 40
Kocka të rrjepura lopësh ..... 41

**Dritaret e verbëta**
**Cikli i dytë**

Kudo kollitet stina plakë ..... 44
Veç murrlani i egër s'bëzan ..... 45
Nën një çati të rrënuar ..... 46
Pamë se si lahej një zog në pluhur ..... 47
Në ato kohëra të mira ..... 48
Një natë me yje prush ..... 49
Nuk pushon vaji i zanave të ujit ..... 50
Përherë flenë me sy të hapur ..... 51
Dritaret e verbëta ..... 52
Nuk di a t'i shkruaj një lutje zotit ..... 53
I zgjasim duart nëpër thellësira ..... 54
Endte një tjetër rrjetë ..... 55
Kjo gjuhë e lashtë e malit ..... 56
Një njeri doli nga parzma e dheut ..... 57
Para dyerve të mbyllura galopon era ..... 58
Deri sa nga drurët e çatisë ..... 59
Qajnë edhe shirat ..... 61
Jam lodhur ..... 62
Ngjajnë me hingëllimat e kuajve ..... 63
Kudo acar në pemishtet e ngrira ..... 65
Hënëzat kishin aq shumë uri ..... 66
Thërrasin e këlthasin ..... 67
Të prite diku në fund të dhomës ..... 69
Kështu ngjau edhe me yjet ..... 70
Duke i shikuar gurtë e vjetër ..... 71
Ose ne të gjithë ishim një dimër ..... 72
Ah kur isha i ri ..... 73

**Tinëzisht rrotullohen zaret e fatit**
**Cikli i tretë**

Brenda mureve të kujtesës ..... 76
Shpërdridhet një histori e harruar ..... 77
E njoha edhe kryqin tim ..... 78
Duket më i mbrapshtë ..... 79
2. ..... 80
3. ..... 81
Një stinë asnjanëse ..... 82
Mbi një araba të vjetër ..... 83
Tinëzisht rrotullohen zaret e fatit ..... 84
Marshojnë miqtë e mi ushtarë ..... 85
Me rropullitë e të gjitha llojeve ..... 86
Asgjë sonte nuk qenka ndryshuar ..... 87
Vdesin edhe vetë kronikat ..... 88
Rrufetë e pareshtura i kanë shaluar kuajt ..... 90
Çdo kush do më njihte se jam Shqiptarë ..... 92
Diku në sfond të pasqyrës ..... 93

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Dritaret e verbëta / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : Trend, 2015. – 108 f. ; 21 cm.

[Shënime për autorin] : f. 96-105

**ISBN 978-9951-694-04-9**